

FRETËRIT MARRIN QËNDRIM NDAJ RACIZMIT SISTEMIK

I kemi parë të gjithë pamjet e ardhura nga Shtetet e Bashkuara dhe, në masë më të vogël, nga Mbretëria e Bashkuar, që tregojnë se sa shumë janë kthyer në skenë problemet tashmë historike të lidhura me diskriminimin e me racizmin e sistemit, dhe se sa thellësisht të rrënjosura janë shfaqur ato. Sigurisht, racizmi është një fenomen universal; në asnjë anë të botës nuk ekziston një shoqëri e përsosur që të ketë respekt për të gjithë. Por tradita jonë françeskanë dhe përshpirtëria jonë japin një vizion të botës në të cilin vëllazëria është thellësisht e përfshirë. Në të vërtetë, neni 40 i Kushtetutave tona Gjenerale pohon: *“Fretërit, edhe pse të pajisur me karakter, kulturë, doke, talente, prirje dhe cilësi të ndryshme, e pranojnë njëri-tjetrin në realitetin përkatës të tyre, siç janë dhe si të barabartë, në mënyrë që e gjithë Vëllazëria të bëhet vendi i privilegjuar i takimit me Hyjin”*.

Nëpërmjet disa deklaratave publike, fretërit në Shtetet e Bashkuara kanë shprehur dëshirën e tyre për të dalë në anën e atyre që janë të shtypur:

[...] mbetemi solidarë me vëllazërit e motrat tona afroamerikanë të cenuar që kërkojnë fundin e dhunës shkatërrimtare të racizmit. Nuk mund të jemi indiferentë kur cenohet dinjiteti që atyre u ka dhënë Hyji.

Si njerëz feje, jo vetëm e dënojmë racizmin sistematik që ka çuar në këto ngjarje, por edhe angazhohemi përsëri për t'i dhënë fund padrejtësisë raciale në provincat tona, në Kishën tonë e në kombin tonë dhe të krijojmë atë hapësirë në të cilën Bashkësia e Dashur e dr. Martin Luter Kingut do të lulëzojë.

(Deklarata e Ministrave provinciale të gjashtë Provincave Amerikane, teksti i plotë në ofm.org).

Disa Ministra provinciale më pas u kanë dërguar fretërve të tyre mesazhe të thelluara që japin nxitje të ndryshme për lexime dhe reflektime personale të mëtejshme.

Ministri provincial i Provincës Holy Name (Nju Jork), fra Kevin Mullen ka shkruar:

Përvoja ime personale e jetuar në provincën “Holy Name” (Emri i Shenjtë) më ka mësuar t'i përballoj problemet nëpërmjet tri lenteve të ndryshme: asaj vëllazërore, asaj baritore dhe asaj të reflektimit personal. Nëpërmjet lentes së vëllazërisë, e di se vdekja e George Floyd-it ka nxitur zemërim në provincën “Holy Name” dhe u ka shkaktuar një dhimbje të madhe vëllazërve afroamerikanë, hispanikë apo aziatikë, të cilët e kanë pësuar edhe mbi shpatullat e tyre “privilegjin e bardhë” dhe racizmin brenda vëllazërisë sonë, në Kishë dhe në botë. Duke reflektuar, kuptoj se kam ndihmuar në dhimbjen e tyre – jo qëllimisht me vepra apo fjalë – por me indiferencën time apo me paaftësinë për veprim, ose duke mos ia vënë veshin britmës drejt meje dhe drejt vëllazërve [...]. Nëpërmjet lentes së baritores, njoh nevojën për ta përfshirë temën e racizmit brenda ungjillëzimit të zakonshëm, për shembull në predikimin liturgjik, në edukimin fetar dhe në katekezën e të rriturve. Mjerisht, mëkati i racizmit nuk njihet,

as nuk konsiderohen në mënyrë të drejtë pasojat e tij në shumë prej bashkësive të drejtuara nga fretërit. Duhet të bëjmë më shumë. [...] Së fundi, nga këndvështrimi i reflektimit personal, duhet të vazhdoj të dokumentohem dhe të reflektoj, por sidomos duhet të dëgjoj zërat e motrave e të vëllazërve me ngjyrë që dëshirojnë të bashkëndajnë përvojën e tyre. (Teksti i plotë: hnp.org)

Fr. David Gaa, Ministër provincial i provincës “Santa Barbara” (San Francisco) ka bashkëndarë disa nxitje për reflektim:

Duhet ta pranoj faktin se ndihem në siklet dhe kuptoj se është mirë t'i bëj të ndihen në siklet edhe të tjerët. E vërteta është se kam pasur dobi dhe vazhdoj të kem dobi prej privilegjit të bardhë. Kjo është vërtet e vështirë për mua që ta pranoj.

Angazhimi im ndaj drejtësisë sigurisht që duhet të ketë parësinë. Duhet të mos kem frikë se do të fyej të tjerët kur flas për racizëm.

Duhet të studioj dhe të reflektoj më shumë në lidhje me racizmin. Jam mjaft i paditur në histori dhe kuptoj se historia që kam mësuar kur kam qenë fëmijë është e paplotë. (Teksti i plotë: [@SBFranciscans Facebook](https://www.facebook.com/SBFranciscans))

Në letrën drejtuar provincës së tij të Shën Gjon Pagëzuesit (Cincinnati), Ministri provincial fra Mark Soehner ka deklaruar:

Si i bardhë, do të doja të flisja për një realitet që nuk merret mjaftueshëm në konsideratë prej neve që i përkasim kulturës mbizotëruese. Pjesa më e madhe e jona nuk shfaq një sjellje haptazi të bazuar në paragjykime raciale. Si rrjedhojë, nuk e kuptojmë se ne kemi disa privilegje të cilat i gëzojmë si të bardhë. Meqenëse pjesa më e madhe e jona nuk ka qenë kurrë një person me ngjyrë, nuk jemi në gjendje ta pranojmë pasaportën kulturore që kemi. Ajo quhet “privilegji i bardhë”. Richard Rohr (OFM), në një intervistë të vitit 2016 e ka përshkruar këtë privilegj të bardhë si “mendjemadhësia se ne i përkasim gjithmonë dhe nuk duhet ta fitojmë përkatësinë tonë. Vetëm dikush nga jashtë mund ta vërejë në ne këtë qëndrim”. (Shiko videon: [FranciscanMedia.org](https://www.franciscanmedia.org)).

Gjithashtu, këta vëllazër sugjerojnë [leximin e artikullit të shkruar nga atë P. Bryan Massingale, i botuar në National Catholic Reporter](#), që paraqet një reflektim në lidhje me temën e “mburrjes”, të lidhur me privilegjin e bardhë dhe paraqet një plan veprimi në gjashtë pika që mund të përdoret nga vëllazëritë lokale dhe nga individët për reflektimin dhe diskutimin, që duhet të konsiderohet pjesë e një programi të mbështetur nga provinca.

Le t'ia lëmë fjalën e fundit papës Françesku (3 qershor 2020): *“nuk mund të tolerojmë as të mbyllim sytë para çfarëdo lloj racizmi apo përjashtimi dhe të pretendojmë se mbrojmë sakralitetin e çdo jete njerëzore”*.

FRETËRIT NË LINJË TË PARË GJATË PANDEMISË

Nëse ju dhe fëmijët tuaj keni uri, kërcënimi i koronavirusit e përmbys listën e parësive. Por është e vërtetë edhe se karantinimi i COVID-19 në të gjithë botën ka treguar se si personat nevojtarë që jetojnë ditë për ditë janë të goditur në mënyrë tejet të rëndë. Lufta e tyre bëhet edhe më e ashpër kur edhe ato pak burime të tyre të fitimit zhduken.

Fretërit e të gjithë botës janë duke u përpjekur të ecin përkrah motrave e vëllezërve të tyre që në këtë moment gjenden në një nevojë të dëshpëruar. Ja disa shembuj që do t'ju frymëzojnë dhe, ndoshta, do t'ju japin edhe ju ide për të arritur te ata!

MEKSIKË

Monklova (pop. 230.000) gjendet në verilindje të Meksikës. Për shkak të një gabimi njerëzor në klinikën kryesore shëndetësore të qytetit, ky qytet është duke u përballur me një vatër të fortë të COVID-19. Kjo ka sjellë krizën e ekonomisë lokale sepse vërtet shumë persona nuk mund të punojnë; shumë firma janë mbyllur dhe punëtorët e tyre kanë një pagë tejet të reduktuar që nuk mund t'i mbajë familjet e tyre. Si përgjigje, fretërit lokalë janë angazhuar të dorëzojnë pako ushqimore (më shumë se 1.500 deri tani) dhe kanë filluar edhe të prodhojnë maska mbrojtëse.

SHBA

Shumë ministra françeskanë e kanë fuqizuar mobilizimin e tyre. Siti web i provincës së Holy Name-it paraqet një panoramë të asaj se si fretërit dhe vullnetarët e formuar, duke iu përshtatur udhëzimeve të qeverisë, janë duke

organizuar në mënyrë të sigurt mensa për të varfrit dhe shpërndarje të bukës. Sfidat është që të plotësojnë kërkesën gjithnjë e më të madhe duke u përpjekur të arrijnë maksimumin me më pak burime se zakonisht. Me shtimin në rritje të personave në *St. Francis Inn të Filadelfias*, kanë filluar të përgatisin ushqim për ta marrë me vete. Megjithatë është dashur të pezullohet pjesa më e madhe e veprimtarive, *Shenjtërorja e Shna Ndout* në Boston ka çuar përpara shërbimet thelbësore, përfshirë edhe *Franciscan Food Center*.

Garazhi i shenjtërores tani funksionon si bazë për shpërndarjen e ushqimeve familjeve dhe personave të regjistruar në qendrën ushqimore. Për informacione të mëtejshme, [kliko këtu](#).

POLONI

Njëra prej provincave polake OFM (Zoja Nunciatë) ka dhënë ndihmesën e vet në mënyrë të ndryshme, duke ndihmuar financiarisht në mbështetje të spitaleve përveçse edhe të bashkësive e famullive të ndryshme soditëse femërore, si në Ukrainë ashtu edhe në Italinë Veriore. Fra Mieczysław është një frat 78 vjeç nga Katovica që ka kuptuar se karantinimi në burgje do të thotë të kalohet edhe më shumë kohë në izolim. Ai ka pasur idenë gjeniale që të organizojë një furgon plot me libra për t'ua dorëzuar të burgosurve, shumë të kënaqur që t'i marrin e, edhe më mirënjohës për faktin se ai i kishte kujtuar. Shiko historinë në [ofmjp.org](#).

GUINEA-BISAU

Falë financimeve të Caritas-it dioqezan të tyre, në [misionin dhe famullinë françeskane](#) të Kuinhamelit (që gjendet rreth 30 km larg kryeqytetit, Bisau) ka qenë e mundur të ndihmohen më shumë se 30 fshatra rreth e rrotull. Fretërit kanë nxitur nisma shëndetësore, kanë dhënë informacione, kanë edukuar personat në lidhje me rregullat e mira higjieniko-sanitare, u kanë shpërndarë ushqim e ilaçe nevojtarëve, u kanë çuar ilaçe qendrave shëndetësore dhe, madje, i kanë dhënë dispozitiva mbrojtjeje policisë në postobloqe. Bashkëpunëtorët e famullisë janë duke realizuar një regjistrim më të gjerë të personave që vuajnë nga uria. Do t'i përdorin këto informacione kur t'u jepet ndihma e premtuar.

INDONEZI

[GPIC në Indonezi](#) ka punuar shumë. Përveç shpërndarjes së maskave në të gjithë vendin, i ka dorëzuar dispozitivë të mbrojtjes individuale personelit mjekësor që punon në zonat rurale ku burimet janë të pakta. Janë shpërndarë ndihma mjekësore kirurgjike: këmisha, maska kirurgjike, dizinfektantë për duar, mburoja mjekësore, mbikëpucë, mbuloja koke dhe doreza mjekësore. Gjithashtu, më nevojtarëve, grupi u ka shpërndarë edhe ushqime: oriz, makarona të çastit, vezë dhe vaj kuzhine.

Vazhdon në faqen tjetër...





FRETËRIT NË LINJË TË PARË (vazhdon)

MAROK

Për shkak të pandemisë **fretërit në Marok** përballojnë sfida unike në përgjigjen ndaj nevojave të grupeve të ndryshme të personave. Migrantët e arritur në Marok në përpjekje për të arritur Europën janë në vështirësi të mëdha; studentët universitarë të Afrikës sub-sahariane kanë nevojë për mbështetje shpirtërore e sociale; personat e sapo liruar nga burgju, duke mos mundur ta gëzojnë plotësisht lirinë e tyre, kanë nevojë për një vendbanim të përkohshëm. Përveç këtyre problemeve komplekse, çështja më urgjente (garantimi i maskave mbrojtëse për migrantët dhe për personat e vendit), ka nxitur njërën prej vëllazërive françeskane që t'i realizojë dhe t'i shpërndajë ato falas.

ITALI

Bashkësia françeskane e *Carceri-it* në Asizi kohët e fundit ka hapur një treg misionar dhe një dyqan bamirësie. Kjo nismë ka qëllimin që të mbledhë fonde për personat e goditur nga pandemia dhe ka filluar me një ekspozitë “betlehemesh” të bërë me dorë.

GUATEMALË


Në Guatemalë, jetimorja “*Valle de los Angeles*” vazhdon t'u ofrojë një shtëpi mikpritëse dhe një edukim të mirë fëmijëve që i janë besuar. Por edhe kanë bërë gjithçka ka qenë e mundur për t'u përgjigjur nevojave të mëtejshme urgjente të shkaktuara nga dy uraganë shkatërrimtarë që kanë goditur Guatemalën javën e parë të qershorit. Një dhurues bujar i ka kërkuar bashkësisë françeskane të “*Valle de los Angeles*” të bëjë rolin e kanalit të financimit për të ndihmuar mijëra persona që vuajnë prej urisë, për shkak të fatkeqësisë natyrore, të sëmundjeve të ndryshme dhe të papunësisë së shkaktuar nga më shumë se tre muaj karantim për arsye të Covid-19.



SHËNUES LIBRI FRANÇESKAN

SPECCHIO DI ILLUMINAZIONE

Vita di santa Caterina da Bologna
scritta da Illuminata Bembo



Testo italiano e note
a cura di Juri Leoni OFM

JURI LEONI OFM, *Specchio di illuminazione* - Vita di S. Caterina da Bologna scritta da Illuminata Bembo (Pasqyrë ndriçimi – Jeta e Sh. Katerinës nga Bolonja e shkruar nga Illuminata Bembo), Edizioni Biblioteca Francescana, Milano 2020, fq. 232.

Nëpërmjet një teksti larg prej nesh më shumë se pesë shekuj, lexuesi drejtohet për të rijetuar përvojën e jashtëzakonshme të një grupi grash të guximshme, me prejardhje fisnike, plot me dëshirën për ta jetuar rrënjësisht thirrjen e tyre si motra të varfra të shën Kjarës. Figura që spikat brenda këtij grupi është ajo e shenjtës Katerinë nga Bolonja, e rritur dhe e edukuar në oborrin e rafinuar estens në Ferrara, ku studion muzikë, pikturë, vallëzim, mëson të shkruajë poezi dhe bëhet eksperte në artin e miniaturës. Pasi hyn në manastirin e Ferrarës, dërgohet në Bolonja për t'i dhënë jetë manastirit të ri Corpus Domini, ku ende edhe sot ruhet trupi i saj. Nxënësja e saj, Illuminata Bembo, nga një familje fisnike veneciane, pak vite pas vdekjes së saj, do të tregojë jetën e shenjtës që botohet këtu në një version të ri.



ANDREA VAONA OFMCONV, *L'allegria brigata francescana: San Francesco e i suoi primi compagni* (Brigada e gëzueshme françeskane: Shën Françesku dhe shokët e tij të parë), Edizioni Messaggero Padova, Padova 2020, fq. 296.

Nuk mund të mos flasim për shokët e parë të shën Françeskut, dhe kjo për një arsye të thjeshtë: fakti se Varfanjaku i Asizit ka jetuar në një vëllazëri të re ungjillore! Dhe ai vetë e ka përshkruar si “dhuratë të Hyjit” mbërritjen e vëllezërve të tij të parë. Për disa prej tyre na janë përçuar vetëm emrat dhe pak më shumë, por gjithsesi duam t'i kujtojmë. Për të tjerë – Bernardi, Leoni, Rufini, Gjinepri, Maseu dhe Egjidi – edhe “jetët” e hershme në gjuhë latine, që këtu përkthehen në italisht për herë të parë. Janë dëshmi i një françeskanizmi të larmishëm, të vërtetë, pa nderime, të gëzueshëm e rrënjësor, për të cilin do të ketë gjithmonë mall.

NGJARJE



MURCIA, SPANJË: KURS ONLINE MASTERI NË TELOGJI 2020/2021

Masteri në Teologji, një bashkëpunim mes Institutit teologjik të Murcias dhe Universitetit të Murcias, është një master online zyrtar i përbërë nga 60 ECTS (European Credit Transfer and Accumulation System; pra Sistemi Europian i Grumbullimit dhe Transferimit të Krediteve Formuese). Ofrohen 30 vende në tri faza para-regjistrimi: janar, korrik dhe shtator. Ata që kanë marrë një diplomë apo një licencë në Teologji apo Shkenca fetare, mund të regjistrohen si zgjedhje e parë. Megjithatë, masteri në Teologji u drejtohet në veçanti të diplomuarve në Shkenca njerëzore e sociale të interesuar për të ndërmarrë studime teologjike zyrtare.

Informacione:

www.itmfranciscano.org/master-en-teologia-3

ROMË, ITALI: ITINERAR PROFESIONAL NË EKOLOGJI INTEGRALE

Fakultetet e Teologjisë, së Drejtës Kanonike dhe Filozofisë së Universitetit Papnor Antonianum organizojnë për vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022 turnin e dytë të itinerarit profesional në ekologji integrale, që synon të japë një mundësi zhvillimi modeleve të reja të kujdesit për shtëpinë e përbashkët si përgjigje ndaj nxitjeve të enciklikës *Laudato si'* dhe duke nisur si nga reflektimi bibliko-ungjillor e fetar në lidhje me botën e krijuar, si nga tradita françeskane.

Informacione:

www.antonianum.eu

Percorso professionale in
Ecologia integrale



KOIMBRA, PORTUGALI: JUBILEU I MARTIRËVE TË MAROKUT DHE SHNA NDOU

Në përkujtim të tetëqind viteve të martirizimit të protomartirëve françeskanë, si dhe të thirrjes françeskane të Shna Ndout, ipeshkvi i Koimbras ka shpallur një Jubileu, të shoqëruar nga Dekreti vatikanas që shpall një Jubileu me ndjesën e plotë për të gjitha ditët e Vitit të shenjtë 2020-21. Programi dhe informacione të tjera gjenden në www.jubileu2020.pt.

ROMË, ITALI: KURS ONLINE - DYQANI I HAGJIOGRAFIT: MJETE DHE METODA PËR STUDIMIN E BURIMEVE

Shkolla superiore e studimeve mesjetare e françeskane, në bashkëpunim me Société des Bollandistes (Bruksel), u propozon nxënësve dhe studentëve e kërkuesve të akademive të tjera një cikël seminaresh online të kushtuar burimeve hagjiografike. Ky projekt synon t'i shtjerë studentët në "dyqanin e hagjiografit", për të njohur dhe për t'u familjarizuar me mjetet dhe metodat e punës, si dhe për të mësuar që t'i përdorin në studimin e burimeve. Seminaret paraqiten si një kurs specialistik hyrjeje në literaturën hagjiografike, nëpërmjet mësimëve praktike që ofrojnë metoda studimi dhe jo vetëm përmbajtje, mjete pune së bashku me nocione teorike.

Informacione:

antonianum.academia.edu

